

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "ILIRIAM" Sh.p.k.

Sot, me datë 19 / 10 / 2022,

Z. Andrea Marranzini, shtetas Italian, lindur në Romë, Itali, më 18/06/1967, banues në rrugën Livenza 4, 00040, Ardea (Rome), Itali, mbajtës i dokumentit pasaportë me nr. YC0240119, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z. Ilir Visha, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës, Shqipëri, më 13/03/1955, banues në rrugën "Dora D'istria", Pallati Drini, Ap.5, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal F50313204N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ILIRIAM" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ILIRIAM" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në rrugën Muhamet Gjollësja, Godina Qendra Tregtare Ring, Hyrja 2, Apartamenti 14, Tiranë.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.




NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Import - eksport, prodhim, si për vete apo përmes palëve të treta, përfaqësimi, brokerimi, ndermjetesimi tregtar si dhe magazinimi, i produkteve, makinerive dhe impianteve në sektoret: mekanike, kimiko-mjedisor, kimike-metalurgjike, minerar, energjitike, materiale shëndetësore, diagnostifikuese, stomatologjike, pajisje kirurgjikale, pajisje tekniko-shkencore dhe laboratorike, pajisje anti-vjedhje kunderzjarre, videombikqyrje;
- Turizem mjekesor, duke përfshirë të gjithë linjen (zinxhirin) përkatës sipas ligjit, sidomos turizem dentar dhe estetik, me të gjithë aksesoret;
- Import – eksport, prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë, hardware e software, makinave dhe mobiljeve të zyrës;
- Tregti me pakicë dhe shumicë, sipas korrespondencës postare dhe on-line (e-tregtia);
- Ndërtimi i impianteve teknologjike dhe speciale, ofrimi i shërbimeve të asistencës teknike;
- Agjensi përfaqësimi të prodhimeve të sipërcituara;
- Shërbime konsulence në fushat e mesipërme, shërbime dhe menaxhim i objekteve dhe shërbim global;
- Menaxhimi dhe kontrolli i kontratave të shërbimeve, konsulte menaxhimi, dizejnimi;
- Menaxhimi dhe kontrolli i kontratave të menaxhimit të objekteve dhe të shërbimit global;
- Shërbime logjistike lidhur me shpërndarjen e mallrave, trajtimi i mallrave, pranimi, ruajtja;
- Zhvillimi dhe ruajtja e të dhenave, menaxhimi i call center;
- Këshilla dhe ndihmë teknike për aktivitetet e shqyrtuara në objektin e shoqërisë;
- Projektimi dhe organizimi i kurseve të trajnimit profesional, udhëzimeve teorike dhe praktike, kongrese, konventave, studiove dhe ditëve të trajnimit;
- Monitorimi i mjedisit, analiza kimiko-fizike, lengjeve ushqimore dhe perzierjeve të këtyre lengjeve;
- Marketing me shumicë dhe me pakicë të produkteve ushqimore në përgjithësi;
- Marketing me shumicë dhe me pakicë të produkteve estetike;
- Menaxhimi i qendrave fizioterapike dhe estetike;
- Krijimi i një sipërmarrje të përbashkët të huaj, pjesëmarrja në konkurset ndërkombëtare.

Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet me objektin e sipërpërmendur. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, dhe veçanërisht ajo mund të kontribuojë në garanci hipotekore, për blerjen e sipërfaqeve të ndryshme toke, e në përgjithësi mund të kerkojë çdo lloj financimi me banka e shoqëri



perkundrejt te gjitha garancive hipotekore dhe te luajtshme, te kerkuara nga banka, si dhe operacione industriale, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise, te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kanë objekt te njëjtë, te ngjashëm apo qe lidhet me te vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i përbërë nga 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Andrea Marranzini**, zotëron 1 kuotë, me 75% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) Lekë dhe 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Ilir Visha**, zotëron 1 kuotë, me 25% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) Lekë dhe 25.000 (njëzetë e pesë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Ilir Visha**, shtetas Shqiptar, lindur në Kukes, Shqiperi, më 13/03/1955, banues në rrugen "Dora D'istria", Pallati Drini, Ap.5, Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. personal F50313204N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administrator i shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.



NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe atë Italiane me vlerë të njëjtë ligjore.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaket themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Ilir Visha**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

ANDREA MARRANZINI

ANDREA MARRANZINI

Andrea Marranzini

ILIR VISHA

Ilir Visha

Ilir Visha